



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 94/2 Prot

Tiranë, më 05.04.2022

**V E N D I M**

Nr.47, datë 05.04.2022

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 213, datë 7.1.2022, për transferimin e përkohshëm të nëpunës \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**Vërej se:**

Nëpërmjet një kërkesë, të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 94 prot., datë 24.1.2022, nga nëpunësja \*\*\*\*\* , është ngritur pretendimi se, në kryerjen e transferimit të saj të përkohshëm, aktualisht në pozicionin “Përgjegjës Sektori Financë/Kontabilitet”, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, pranë DPD, nuk janë respektuar rregullat e legjislacionit të shërbimit civil për shkaqet e mëposhtme: *së pari*, transferimi i përkohshëm është bërë në një pozicion pune me kategori më të ulët, në kundërshtim me atë ç’ka parashikojnë aktet ligjore në këtë rast; *së dyti*, urdhëri i transferimit të përkohshëm nuk ka të përcaktuar qartësisht afatin dhe kohëzgjatjen e transferimit, prandaj ajo duhet të kthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton se, nëpunësja \*\*\*\*\* me aktin nr.5359, datë 25.2.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është emëruar në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në një kohë kur institucioni, nuk ishte pjesë e shërbimit civil. Me fillimin e efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, u përfshi në fushën e shërbimit civil, rregullim ky që materializohet edhe në Kodin Doganor, të miratuar me ligjin nr.102/2014, të ndryshuar, ku parashikohet se, *punonjësit e administratës doganore, me përjashtim të punonjësve administrativë, janë nëpunës civilë (neni 13, pika 1).*

Në kushtet kur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil, vendi i punës i punonjësës \*\*\*\*\* përfshihej në fushën e veprimit të këtij ligji dhe ajo plotësonte kërkesat e përgjithshme e të veçanta për t’u deklaruar si nëpunës civil, Departamenti i Administratës Publike, bazuar në nenin 67, të ligjit dhe kreun III, pika 2, të Vendimit nr.116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”, me aktin nr.3304/304, datë 30.10.2014, ka deklaruar statusin e saj të punësimit, “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, konfirmuar “nëpunës civil” në këtë pozicion, me aktin nr. 14212, datë 10.6.2015, të eprorit direkt.

Nga këqyrja e mëtejshme e akteve rezulton se, nëpunësja në fjalë, pas ristrukturimit të fundit të kryer në këtë institucion, me aktin nr.7792/75, datë 1.11.2018, të DAP, është konfirmuar përsëri në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës”, dhe mbi këtë bazë, ka dalë akti nr.27111, datë 15.11.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për emërimin e saj në pozicionin e mësipërm.

Pasi ka marrë këtë emërim, rezulton se, për nevoja të institucionit, me aktin nr. 213, datë 7.1.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëpunësja \*\*\*\*\* është transferuar përkohësisht, në pozicionin “Përgjegjës Sektori Financë/Kontabilitet”, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, pranë DPD, transferim të cilin ajo e ka kundërshtuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave (e drejta e ankimit dhe detyrimi për të shqyrtuar ankesën, janë parashikuar në pikën 18, Kreu V, të VKM nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar).

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pasi ka marrë në shqyrtim rastin, ka konkluduar duke kthyer edhe përgjigje me shkrim, se transferimi është kryer në interes të institucionit, bazuar në nenin 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe kërkesave specifike të Kodit Doganor, në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor. Përsa i përket transferimit të saj në një pozicion pune të kategorisë më të ulët, nga ana e institucionit, është arsyetuar se, pavarësisht që është transferuar në një pozicion të kategorisë

më të ulët, niveli i pagës nuk ka ndryshuar, duke respektuar në këtë mënyrë pikën 5, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i cili parashikon përfitimin e pagës më të lartë, ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar nëpunësi civil.

Duke mos qenë dakord me këtë qëndrim të institucionit, punonjësja në fjalë, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, për anulimin e urdhërit të transferimit të përkohshëm për shkak të paligjshmërisë së tij dhe kthimin në vendin e saj të punës si “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës”, në DPD, ku ajo ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të transferimit të përkohshëm në këtë rast, që në fillim konstatojmë që, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (*pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor*), janë parashikuar disa rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, në pikën 7, të nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” përcaktohet se: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Siç shihet, sipas dispozitës së mësipërme, një nëpunës doganor, mund të transferohet përkohësisht për nevoja të institucionit sa herë lind e nevojshme, pa patur ndonjë kufizim ligjor në shpeshhtësi, duke evituar kufizimin e dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës lejohet të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (*njëherësh ose e copëzuar*) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve.

Ndërkohë, duke e parë në brendësi përmbajtjen e aktit nr. 213, datë 7.1.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, konstatohet se në këtë rast ndonëse është përcaktuar që transferimi i përkohshëm, është bërë për nevoja të institucionit (*pika 7, shkronja “a” (i), e nenit 15, të ligjit nr.102/2014, “Kodi Doganor i RSH”*), por kohëzgjatja nuk është shënuar në akt, gjë e cila sipas njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, dispozita referuese e aktit e parashikon në mënyrë të shprehur afatin maksimal të transferimit të përkohshëm, që prezumohet se nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj. Kjo mangësi e aktit është një element

paligjshmërie i tij pasi si rregull, në përmbajtjen e tij duhej të ishte përcaktuar në mënyrë të shprehur koha e transferimit të përkohshëm dhe data e kthimit në pozicionin e mëparshëm, gjë e cila do të siguronte një stabilitet në marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil dhe transparencën e nevojshme, duke i siguruar nëpunëses mundësinë që të kërkojë konkretisht rivendosjen e të drejtës së saj, prandaj pretendimi në lidhje me mos përcaktimin në akt të afatit dhe kohëzgjatjes së transferimit, është i drejtë.

Ndërkaq, nga verifikimi i mëtejshëm i këtij rasti rezulton e vërtetuar që, pozicioni i punës ku është transferuar aktualisht nëpunësja në fjalë, *“Përgjegjës Sektori Financë/Kontabilitet”*, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, pranë DPD, pavarësisht se ka kaluar në një pozicion me kategori më të ulët se pozicioni i përhershëm i nëpunëses, është urdhëruar që pagesa të bëhet me kategorinë e pagës III-a (Aneksi nr. 1, bashkëlidhur VKM nr. 2, datë 8.1.2018, *“Për disa ndryshime në Vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar”*), që është e njëjtë me kategorinë e pagës së mëparshme.

Pra, në këtë rast, institucioni pranon faktin se ka lejuar transferimin e përkohshëm në një pozicion me kategori page më të ulët (III-a/1), por e justifikon me argumentin se, pavarësisht këtij fakti, ka ruajtur kategorinë e pagës së mëparshme. Ky është një element tjetër i paligjshmërisë së aktit në fjalë për transferimin e përkohshëm të nëpunëses doganore \*\*\*\*\*, pasi duke u paguar për një pozicion me kategori më të lartë se pozicioni i punës që kryen realisht gjatë transferimit, është shkelur parimi i shpërblimit sipas punës (*neni 49, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417 dt. 21.10.1998 dhe nenet 109, 110, 115, etj., të Kodit të Punës së Republikës të Shqipërisë*).

Pretendimi i institucionit se pagesa është bërë në zbatim të pikës 5, të nenit 48, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, është i padrejtë pasi sipas kësaj dispozite, nëpunësi civil gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm përfiton pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar, por gjithmonë kur është respektuar kushti i transferimit të përkohshëm, brenda të njëjtës kategori ose në një kategori më të lartë.

Duke e analizuar këtë rast në raport me legjislacionin doganor, pozicioni drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, është përfshirë në nivelin e nëpunësisë kategoria A, me kategori page III-a, ndërsa pozicioni përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, ku është transferuar kërkuesja, i përket nivelit të nëpunësisë kategoria B, me kategori page III-a/1 (pika I/1/iv/v, e VKM nr. 2, datë 8.1.2018).

Theksojmë këtu se, punonjësit e administratës doganore, të cilët përfshihen në kategorinë A, B, C1 dhe C2, sipas pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, janë pjesë e shërbimit civil.

Referuar pikës 5 dhe 6, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pozicioni “Drejtor Drejtorie”, i përket kategorisë së mesme drejtuese, ndërsa pozicioni “Përgjegjës Sektori”, i përket kategorisë së ulët drejtuese. Këto pozicione, ndryshojnë si përsa i përket nivelit të pagës, emërtesës, si edhe të detyrave që ato kryejnë, duke ju referuar në këtë rast, edhe legjislacionit doganor.

Nga sa më sipër, në analizë të fakteve dhe të akteve ligjore e nënligjore, arrihet në përfundimin se, transferimi i përkohshëm i nëpunëses \*\*\*\*\*, nga pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës”, në pozicionin “Përgjegjës Sektori Financë/Kontabilitet”, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, pranë DPD, është bërë në kundërshtim me pikën 7, shkronja “a”, të nenit 15, të kodit doganor (e cila është me përmbajtje të njejtë me rregullimin që i bën pika 1, e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar), ku parashikohet se, *punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njejtës kategori, apo në një kategori më të lartë*”.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, që në bazë të neneve 109, pika “d” dhe 113 pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, të anulojë aktin nr. 213, datë 7.1.2022, dhe të urdhërojë kthimin e nëpunëses \*\*\*\*\* në pozicionin e saj të punës si “Drejtor në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për shkak se transferimi i përkohshëm në pozicionin “Përgjegjës Sektori Financë/Kontabilitet”, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, pranë DPD, është i kundraligjshëm.
2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **15** ditë, nga marrja dijëni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

4. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve që nuk kanë kryer detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljes së konstatuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**